

GJYATA SUPREME E KOSOVËS , kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit , S. R. F. ..., Luzern e në – Zvicër, të cilin e përfaqëson me autorizim ,av. B. N.,nga ..., kundër të paditurës KS''E.'' në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Q. A., lidhur me regresimin e dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.24/2016 datë 05.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27.02.2019, mori këtë

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës KS''E.'' në Prishtinë, , i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.57/2013 datë 10.6.2014.
- II. Pranohet revizioni i të paditurës vetëm sa i përket vendimit për kamatën e aprovuar ,dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.24/2016 datë 05.11.2018dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështjet Ekonomike III.C.nr 150/2015 , i datës 26.09.2016 ashtu që në shumën e gjykuar në lartësi prej 80,037.04 € ,detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj me kamatën prej 8 % ,duke filluar nga 11.03.2014 e tutje deri në përmbushjen përfundimtare të borxhit.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.24/2016 datë 05.11.2018 , është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, III.C.nr 150/2015 , i datës 26.09.2016 me të cilën obligohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shumën prej 80,037.04 € ,me kamatë prej 12 % duke llogaritur nga data 11.03.2014 , deri në pagesën definitive ,të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga e pranimit të këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Detyrohet e paditura që paditësit të kompensoj shpenzimet procedurale në shumën prej 2.915,6 , në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së

drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të njëjtin të njëjtën ta prishë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në përgjigje në revizion paditësi ka propozuar që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pabazuar dhe aktgjykimi i goditur të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 e lidhur me nenin 505 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës, pjesërisht është i bazuar .

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur me datën 01.05.2016 , aksidentohet S.. B.,me vendqëndrim në ..., si drejtuesi i automjetit "V. P." me targa të regjistrimit ..., dhe pjesëmarrësi tjetër M. D., e siguruar te e paditura . Në këtë aksident të komunikacionit lëndime të lehta trupore ka pësuar S. B., fillimisht trajtohet në Kosovë, më tutje në Zvicër , në cilësi të siguruarit të paditësit, e cila paraqet sigurimin e detyrueshëm social, bartë të gjitha shpenzimet mjekësore të shërimit të S. B., në shumë prej 80,037.04 € Paditësi kërkon rimbursimin e shumës së paguar, nga i siguruari i automjetit, i cili ka pësuar lëndime i dëmtuari, dhe se i siguruari i paditurës ka qenë fajtor i shkaktimit të aksidentit të komunikacionit.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara dhe gjendjes së vërtetuar faktike ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses për regresin është e bazuar në shumën e aprovuar të kërkesëpadia, pasi që ekziston detyrimi i të paditurës që sipas drejtës së subrogimit, t'ia paguajë paditëses shumën prej 80,037.04 € në kuptim të nenit 960 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta zyrtare e RSFJ nr. 04/L-077) me kamatë prej 12% duke llogaritur nga data 11.03.2014 ,deri në pagesën definitive. Gjykata e shkallës së parë në bazë të raportit ekspertëve mjeko ligjor ka vërtetuar se shpenzimet e shërimit të siguruarit të paditësit janë në lidhje kuazale me lëndimet e pësuar në aksidentin e komunikacionit ë datës 01.05,2013 , që është shkaktuar me fajin ekskluziv të siguruarit të paditurës .

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka obliguar të paditurën të paguajë paditëses në emër të rimbursimit shumën prej 80,037.04 €

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët, në gjendjen e vërtetuar faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, ashtu që gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur ka refuzuar ankesën e të paditurit, pasi që aktgjykimi goditur nuk është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson si të pabazuara thëniet e revizionit të paditurës se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë arsyetuar në aktgjykimet e veta se në bazë të cilave prova të cilat fakte i kanë vërtetuar, pse dhe si i kanë vërtetuar ato fakte, cilat prova i kanë shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato e që kjo paraqet shkelje nga neni 160.4 të LPK-së, ngase sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit me aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë vlerësuar të gjitha provat në bazë të nenit 8 të LPK-së, dhe japin arsye të mjaftuara se me të cilat prova cilat fakte janë vërtetuar dhe në bazë të kësaj gjendjeje të vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat materiale juridike. Aktgjykimet e gjykatave të instancës të ulët ,nuk janë përfshirë me shkelje nga neni 182 (n) të LPK-së ngase të njëjtat përmbajnë arsye të plota për faktet vendimtare, të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se me aktgjykimet e atakuara nuk është përcaktuar saktësisht kontributi i pjesëmarrësve në këtë aksident dhe se nuk është nxjerrë prova me ekspertin e komunikacionit, me të cilën do të përcaktohej kontributi i pjesëmarrësve në aksident, pasi që e paditura në shqyrtimin kryesor nuk ka propozuar prova me të cilat do të vërtetohej fakti se a ka ekzistuar përgjegjësia e ndarë në këtë aksident komunikacioni.

Paditësja i ka paguar shpenzimet e shërimit të S. B. në Zvicër dhe ka paraqitur prova për këto shpenzime dhe në bazë të pasqyrës së pagesave që arrin shumën për rimbursim, prandaj nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit nuk ka arsyetuar se përfaqësuesi i paditëses a ka precizuar kërkesëpadinë.

Mirëpo, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë lidhur me pjesën që ka të bëjë me kamatën e gjykuar përfshihet me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 382 LMD-së(nr 04/L-077), dhe lidhje me nenin 26.7 të Ligjit për sigurinë e detyrueshëm nga auto përgjegjësia nr (04/L-018 e cila ka hyrë në fuqi më 30 korrik 2011).

Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale qëndron në faktet se , si është thënë më lartë, kërkesëpatria e paditësit për shpërblim të dëmit si dhe patria është paraqitur në kohën kur ka hyrë në fuqi Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Kamata e aprovuar nga gjykatat e instancës më të ulët, ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit në fjalë dhe nenit 5.1 të Rregullit të BQK-së nr. 3 mbi ndryshimin e Rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia të datës 25 shtator 2008, në të cilat dispozita thirren gjykatat e instancës së ulët. Ato kamata të cilat i kanë aplikuar gjykata e shkallës së parë dhe të dytë janë të parapara me qëllim të disiplinimit të kompanive sigurorese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brena afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Par. 7 nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rrënjën në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 LMD jo edhe kamatë ‘të kualifikuar’ sipas dispozitave të zbatuara nga gjykatat e shkallës së parë dhe asaj të dytë. Meqenëse, paditësja me parashtrësën e datës 11.3.2014 ka kërkuar regresim të borxhit nga e paditura, rezulton se e paditura nga ko datë ka rënë në vonesë kur nuk e ka mbushur detyrimin brena afatit deri në pagesën definitive.

Nga arsyet e dhëna më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

E.Rev.nr.1/19 datë 27.2.2019

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri

